



Pranuar / Dorezuar Primjen/Prodato Received/Delivety	13.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	6061/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.925/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.555/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.61/2020 të datës 27.02.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Ndue Përlleshi", Objekti 3L-B-5, Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.03/03 të datës 19.02.2020 dhe Vendimit me Nr.04/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.61/2020 e datës 27.02.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 27.02.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 527/2020 të regjistruar me numër A.nr.61/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.03/03 të datës 19.02.2020 dhe Vendimit me Nr.04/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 04.03.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Sekretariati Koordinuar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Këshilli më datë 06.03.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit se bashku me shkresat e lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.555/2020 ka detyruar Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 27.02.2020 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.02.2020 me Nr.prot:527/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.04/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e me Nr.10/95 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendim për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës; Njoftimin e datës 04.03.2020; Përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit bashkë me provat e lëndës, Vendimin me nr.926 të datës 25.03.2019 të Ministrit të Ministrisë së Administratës Publike; Deklaratën e Pajtushmërisë me Rregulloren e punës së Qeverisë Nr.09/2011; Propozim vendimin e panëshkruar; Vendimin e datës 22.03.2019 të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Kërkesën e datës 26.11.2021 për KPMSHC nga ankuesi; Aktgjykimin A.nr.555/2020 i datës 15.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; E-mailin zyrtar të datës 18.11.2021; Vendimin me Nr.08/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe E-mailin zyrtar të datës 09.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pabazuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi me Vendimin Nr.10/95 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 26.03.2019 është emëruar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, me mandat tre (3) vjeçar. Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.02.2020, ka nxjerr Vendimin Nr.03/03 të datës 19.02.2020, për kalimin në listë rezervë të Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive të cilat janë prekura nga riorganizimi sipas Vendimit Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pjesë e listës rezervë ka qenë edhe pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në këtë rast ankuesit,

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin me Nr.04/03 të datës 19.02.2020, ka ri caktuar z. _____ nga pozita Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Vendimi me Nr.03/03 i datës 19.02.2020 dhe Vendimi me Nr.04/03 i datës 19.02.2020 të Qeverisë së Kosovës, janë nxjerr më shkelje të dispozitave kushtetuese dhe dispozitave ligjore respektivisht Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civilë, Rregulloren (QRK)-Nr.17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.08/2012 për Nëpunësit Civilë Tepricë.

Kolegji me rastin e shqyrtimit të provave të lëndës të siguruar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës ka gjetur se ankuesi pas kalimit në Listën Tepricë të Sekretareve të Përgjithshme, deri në rikaktimin e tij në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Standardizimit sipas Vendimit me Nr.08/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Republikës Kosovës, është paguar sipas pagës të përcaktuar për Sekretar të Përgjithshëm.

Kolegji ka konstatuar se në kohën e nxjerrjes së vendimeve të konstatuara ka qenë i aplikueshëm Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës, e mbi këtë bazë ligjore janë trajtuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit. Kolegji, bazuar në dispozita e Ligjit Nr.04/L-149 për



Shërbimin Civilë përkatësisht nenin 32 paragrafi 1 dhe 2 ku është përcaktuar se: 1. Nëpunësit civilë, të cilët janë tepricë pas riorganizimit, suprimimit ose bashkimit të organizatës së tyre me një organizatë tjetër në kuadër të institucionit të cilit i takojnë, do të ricaktohen në administratën qendrore ose komunale, po qe se ekzistojnë pozita ekuivalente. 2. Në rast të mungesës së pozitave ekuivalente, nëpunësit civilë tepricë janë në përkujdesje të Qeverisë, gjegjësisht të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, e cila përkujdeset për ricaktimin dhe trajnimin e këtyre nëpunësve civilë, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.08/2012 për Nëpunësit Civilë Tepricë, respektivisht nenin 4 më të cilin është përcaktuar se: "Në rastin e riorganizimit të një institucioni, njësia e personelit ka këto përgjegjësi: 1.1. të identifikojë nëpunësit civilë, pozitat e të cilëve janë suprimuar dhe t'i regjistrojë ata në regjistrin e nëpunësve civilë tepricë; 1.2. të njoftojë nëpunësit civilë tepricë për të drejtat dhe detyrimet e tyre, që dalin nga statusi i nëpunësit civil tepricë që përcaktohet me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (më tej: Ligji) dhe me këtë Rregullore; 1.3. të përpiqet të gjejë një pozitë ekuivalente të lirë për nëpunësin civil, ka konstatuar se në rast të riorganizimit të një institucioni, njësia përgjegjëse krijon listën e pozitave të prekura me riorganizim dhe si rrjedhojë edhe listën e nëpunësve tepricë dhe bën përpjekje që të njëjtit fillimisht t'i sistemojë në pozita ekuivalente.

Andaj, bazuar në këtë konstatim dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi është përfshirë në listën tepricë të nëpunësve civil për shkak se institucioni ku ka qenë i emëruar ankuesi është prekur nga riorganizimi sipas Vendimit Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me përfshirjen e tij në listën tepricë është i pa bazuar. Kolegji po ashtu ka gjetur se ankuesi gjatë kohës së qëndrimit në listën tepricë ka realizuar pagën e Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa i njëjti me datë 21.01.2021 është sistemuar në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, gjegjësisht në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Standardizimit në MTL, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit në këtë kuptim janë të pa bazuar.

Bazuar në rrethanat si me lartë, dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.925/2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Jeton Koca
Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Sekretariatit Koordinues në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative;
- Arkivit të KPMSHCK-së.